

## REZULTATET QË PRITEN:

1

Një vlerësim/studim mbi statusin (situatën) dhe sfidat mbi të drejtat sociale të punës në bashkitë e propozuara.

2

Zhvillimi i ndërgjegjësimit dhe promovimi i mënyrave/qasjeve dhe mjeteve të veprimeve për të drejtat sociale të punës (përfshirë mjetet dixhitale) për transmetimin dhe ofrimin e informacionit për komunitetet e të rinjve (femra dhe meshkuj), duke përfshirë të rinjtë me nevoja të veçanta, komunitetin rom, grupet vulnerabël, OSHC-të, bizneset private dhe autoritetet lokale.

3

Duke u dhënë nën-grante OSHC-ve mundësinë për t'i aftësuar ato në monitorimin e zbatimit të të drejtave sociale të punës.

4

Zhvillimi dhe zbatimi i një programi specifik për ndërtimin e kapaciteteve mbi qasjet/modelet e bazuara në të drejtat sociale të punës në secilën prej bashkive për OSHC-të, të rinjtë, organizatat rinore, bizneset private dhe autoritetet lokale.

5

Zhvillimi i laboratorit të fishave të ideve për edukimin e të rinjve mbi të drejtat e punës në secilën bashki (udhëzues) si nxjerrja e vlerave, qëndrimeve, aftësive, njohurive dhe kuptimit kritik nga stimulumimi.



### Vendndodhja:

**Albania:** Bashkia Fush-Arrëz, Pukë, Klos, Rrogozhinë, Cërrik, Gramsh, Lushnjë, Berat, Selenicë, Himarë.

Kohëzgjatja e projektit - 36 muaj

### Kontakt:

“Studies and Development Center” (SDC)

 Rr. Gjin Bue Shpata, 6/ 29,  
Tirana, Albania

 +355 69 22 58242

 [info@sdc.org.al](mailto:info@sdc.org.al)

 [www.sdc.org.al](http://www.sdc.org.al)

Ky botim u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmajtja e tij është përgjegjësi e vetme e "Qendrës së Studimeve dhe Zhvillimit" (SDC) dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



Funded by  
the European Union

## PROJECT

Building Bridges: Bridging  
the Gap in Employment  
Rights through Youth and  
CSO Engagement

Ndërtimi i Urave:  
Kapërcimi i Hendekut në  
të Drejtat e Punësimit  
përmes Angazhimit të të  
Rinjve dhe OSHC-ve

## OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM:

Përmirësimi i kapaciteteve të të Rinjve, OSHC-ve dhe autoriteteve lokale për të integruar Programet/qasjet dhe aktivitetet në të drejtat sociale të punës në axhendën e tyre dhe forcimi i përpjekjeve qeveritare dhe të shoqërisë civile në lidhje me përfshirjen e të rinjve vulnerabël në promovimin e të drejtave të njeriut në punësim.

## OBJEKTIVAT SPECIFIKE:

- Rritja e njohurive dhe informacionit mbi situatën e të rinjve dhe kapacitetet e OSHC-ve në lidhje me sfidat kryesore mbi të drejtat e njeriut, veçanërisht të drejtat sociale të punës.
- Rritja e ndërgjegjësimit të OSHC-ve, organizatave lokale rinore, qeverisë dhe biznesit privat në 10 bashki mbi të drejtat sociale të punës.
- Mundësimi i mjedisit për OSHC-të dhe të rinjtë (meshkuj dhe femra) veçanërisht në zonat rurale dhe nga komunitetet e varfra të marginalizuara/në disavantazh për të përfitur nga veprime të drejtpërdrejta në mbështetje të promovimit dhe zbatimit të të drejtave të punës sociale.

Ndikimi i pritur i projektit që synon rritjen e kapacitetit të OSHC-ve dhe të rinjve për të advokuar për të drejtat sociale të punës është i rëndësishëm dhe me ndikim të gjerë.

